

REKOMANDIME

Konventa Kombëtare për Integrimin European 2021 – 2023

Grupi i Punës V, Sesioni 4: "Nisma për bashkëpunimin rajonal në Ballkanin Perëndimor- arritjet, kufizimet dhe angazhimi i tyre në integrimin në BE"

16 Mars 2023

"Nisma për bashkëpunimin rajonal në Ballkanin Perëndimor- arritjet kufizimet dhe angazhimi i tyre në integrimin në BE trajtoi Çështje që lidhen me Kapitullin 1, 2, 3, 4 dhe 20 me një fokus të veçantë te Tregu i Vetëm Rajonal, objektivat e tij dhe rezultatet në thellimin e integritetit ekonomik dhe rajonal.

- Lëvizja e lirë e mallrave është një nga parimet bazë mbi të cilin bazohet funksionimi i Tregut të Vetëm të BE-së. Në kuptimin praktik, ky parim nënkupton tregti pa pengesa të panevojshme teknike duke respektuar kërkesat e përcaktuara në lidhje me cilësinë dhe sigurinë e produkteve të vendosura në treg. Shqipëria duhet të ketë një vëmendje të shtuar për tu bërë pjesë e nismave të cilat reflektojnë parimet e "katër lirive" mbi të cilat funksionon Tregu i Vetëm Rajonal dhe atyre që përmirësojnë bashkëpunimin politik dhe ekonomik me vendet e tjera.
- Nevojitet forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative dhe financiare të institucioneve që merren drejtpërdrejt me temat që i përkasin kapitujve 1, 2, 3, 4 dhe 20, me mbështetjen adekuate profesionale dhe sektoriale nga aktorët përkatës duke qenë se edhe pse Shqipëria ka bërë hapa para, vendi ynë duhet të përdorë instrumentë specifikë për t'ju afruar standardeve dhe zhvillimit ekonomik të vendeve të tjera të Ballkanit.
- Përsa i përket fushës së shërbimeve në bazë të marrëveshjes së CEFTA, Shqipëria duhet të përmirësojë kuadrin ligjor për shumë shërbime si heqjen e tarifave ose barrierave për zhvillimin e tyre.
- Nevojitet përmirësim i mëtejshëm i kushteve për nxitjen e investimeve, duke përfshirë investimet e huaja direkte. Rekomandohet të vazhdohet harmonizimi i politikave të investimeve me standardet e BE-së.
- Inkurajohet përfshirja e vendit tonë në mekanizmat e tregtimit të emergjencës ose krizës së ushqimit, përfshirja e koridorit ose ndërlihdjes së Ballkanit në hartën e ndërlihdjes europiane.

- Në mënyrë të veçantë duhet të punohet më shumë për fushat që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm, arsimin e lartë, kërkimin dhe inovacionin duke lobuar dhe duke përmbushur kërksat për të pasur një akses më të madh në instrumentet financiare të BE-së.
- Fusha dixhitale është një tjetër shtyllë me rëndësi ku ka arritje që lidhen me politika konkrete. Shqipëria është akoma në fazën e përmirësimit të kuadrit ligjor për shumë shërbime si heqjen e tarifave ose barriave për zhvillimin e tyre dhe duhet të vazhojë me ritjen e kapaciteteve.